



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE



GARANCIA SOVRANE II

Me synim përballimin e pasojave financiare të shkaktuara nga COVID – 19, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin ligjor të mëposhtme në mbështetje të bizneseve të ndikuara në mënyrë direkte ose indirekte nga pandemia Covid-19.

MIRATIMI I GARANCISË SHTETËRORE TË HUAS ME BANKAT TREGTARE PËR GARANTIMIN E HUAMARRJES SË TREGTARËVE OSE SHOQËRIVE TREGTARE SI EDHE PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE E TË KRITEREVE TË MARRËVESHJES SË GARANCISË DHE MARRËVESHJES SË MIRËKUPTIMIT

Në vijim të zbatimit të planit financiar për rimëkëmbjen nga Covid-19 u miratua VKM Nr. 387 datë 13.05.2020 e cila parashikon:

1. Linjën e garancisë shtetërore, në vlerën 15 000 000 000 (pesëmbëdhjetë miliardë) lekë, në favor të bankave që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, pjesë e skemës së garancisë që do të mundësojë huadhënien për tregtarët dhe shoqëritë tregtare për të **siguruar fondet e nevojshme për kapital qarkullues dhe investime** për të mbështetur rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar që është ndikuar nga situata e krijuar nga Covid-19.
2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë garanton 60% të principalit të kësaj Huaje. Në asnjë rast, MFE-ja nuk merr përsipër garantimin e interesave, kamatëvonesave, penaliteteve apo çdo lloj detyrimi tjetër monetar, që mund të burojë nga Huatë që Huadhënësi do t'i lëvrojë Huamarrësve.
3. Afati i Huasë duhet të jetë në diskrecion të Huamarrësit, por jo përtej një afati 5 (pesë) vjeçar.
4. Periudha pa pagesë principali nuk do të jetë më pak se 6 muaj, me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi preferon një periudhë më të shkurtër.

➤ Kriteret që duhet të plotësojë huamarrësi:

1. Huamarrësi duhet të jetë tregtar ose shoqëri tregtare.
2. Mund të jetë subjekt që ushtron veprimtarinë tregtare në të gjithë sektorët e ekonomisë, me kusht që veprimtaria e tij tregtare të jetë prekur direkt ose indirekt nga aktet ligjore dhe nënligjore të qeverisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19.
3. Nuk duhet të ketë detyrime tatimore të papaguara për 3 periudhat tatimore njëkohësisht dhjetor 2019, janar-shkurt 2020, përjashtuar tatimpaguesit të cilët kanë lidhur marrëveshje për pagimin me këste të detyrimeve tatimore si dhe tatimpaguesit, detyrimet e papaguara të të cilëve janë në proces apelimi në të gjitha shkallët.

➤ Rekuperimi post-pagesës së garancisë

Nëse pas 2 (dy) viteve nga data e kryerjes së Pagesës së Garancisë, Huadhënësi nuk ka mundur të rekuperojë detyrimet e Huamarrësit, MFE-ja zotëron të drejtën që të ndjekë vetë procedurat ligjore për rekuperimin e detyrimeve, në masën e çdo pagese të kryer nga MFE-ja, në kuadër të garancisë për këtë Hua, në përputhje me të drejtat dhe mjetet ligjore që ka në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit.

Referenca:

VKM Nr. 387, datë 13.5.2020 *“Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së tregtarëve ose shoqërive tregtare për të mundësuar financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar të ndikuar nga situata e krijuar nga Covid-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimi”-*
<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/05/13/387/6ae17984-5cdd-4b5e-a43c-5413dc0a7a81>

VKM Nr. 480, datë 17.6.2020 *“Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së tregtarëve ose shoqërive tregtare për të mundësuar financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar të ndikuar nga situata e krijuar nga Covid-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimi”-*
<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/06/17/480/554f2798-6705-4e34-aa97-c25f36f40103>